




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Dt. 13.09.2023

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 37 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me nr. të protokollit 02nr.410/04-9473, për shkak të mos-përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit: N.T.SH.“Viktory Com ”& Company “Murseli” sh.p.k.- rr.”Tirana” Gjakovë, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 13.09.2023, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM
Për ndërprerjen e Kontratës

1. Për shkak të dështimit për të përmbushur obligimet kontraktuale, që parqet element thelbësorë të kontratës, Kontrata me numër të prokurimit: 632-19-2174-5-2-1, numër të brendshëm 632-19-2174-5-2-1, numër të brendshëm 632-19-021-521 dhe me nr. të protokollit 01nr.410/04-9473, e datës 16.04.2020, për realizimin e kontratës: ‘Ndërtimi I rrugës së Lipovec-Goden “-Kotratë trivjeçare”’, e lidhur mes në mes të AK Komuna e Gjakovës dhe N.T.SH.“Viktory Com ”& Company “Murseli” sh.p.k.- me seli rr.”Tirana” Gjakovë, NDËRPRITET .
2. Për shkak se Kontraktuesi: N.T.SH.“Viktory Com ”& Company “Murseli” sh.p.k.- me seli rr.”Tirana” Gjakovë, është përgjegjës për mos përmbushje të obligimeve që dalin nga kontrata, obligime këto që janë kusht esenciale dhe themelor i kontratës, NDËRPRITEN së vepruari të gjitha raportet dhe marrëdhëniet Autoritet Kontraktues – Kontraktuesi, të rregulluara me Kontratën me numër të prokurimit: 632-19-2174-5-2-1, numër të brendshëm 632-19-021-521 dhe me nr. të protokollit 01nr.410/04-9473, të datës 16.04.2020, për çka Autoriteti Kontraktues, do të do të ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale – ligjore në pajtim me Kushtet e Kontratës.

4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Punëdhënësit, ka iniciuar aktivitetin për: “Ndërtimi I rrugës së Lipovec-Goden “-Kontratë trivjeçare”, të dt.16.04.2020, me O.E: N.T.SH.“Viktory Com ”& Company “Murseli” sh.p.k.- me seli rr.”Tirana” Gjakovë, për kryerjen e punëve të kontraktuara sipas Kontratës.

Me qëllim të menaxhimit dhe zbatimit në kohë dhe në mënyrë cilësore të kontratës, Zyrtaari Kryesorë Administrativ i Autoritetit Kontraktues – Ardian Gjini, Kryetari i Komunës, me Vendimin e tij , ka emëruar Menaxherin e Kontratës, me të drejta dhe obligimet sikurse janë përcaktuar në Vendim.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tija, përmes kërkesës dërguar në rrugë elektronike ne Zyrën e Prokurimit me date 28.08.2023, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së Prokurimit ndërprerjen e Kontratës për mos realizim të kontratës konform kushteve të kontratës.

Duke qenë se Kontraktuesi: N.T.SH.“Viktory Com ”& Company “Murseli” sh.p.k.- me seli rr.”Tirana” Gjakovë, në vazhdimësi, dhe deri më sot, dt.13.09.2023, nuk është përgjigjur pozitivisht në kërkesat e AK Komuna e Gjakovës. për të kryer të gjitha punët sipas kërkesave teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit , këto veprime të Kontraktuesit, nga ana e AK Komuna e Gjakovës, janë vlerësuar të paarsyeshme, prandaj kontrata ndërpritet duke u bazuar ne nenin 37, paragrafët, a dhe f te Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Bazuar në këtë që u tha më lartë, AK Komuna e Gjakovës, përfundimisht ka vlerësuar se Kontraktuesi N.T.SH.“Viktory Com ”& Company “Murseli” sh.p.k.- me seli rr.”Tirana” Gjakovë, duke mos zbatuar kërkesat e AK Komuna e Gjakovës, për zbatim të plotë të kontratës, është përgjegjës për shkak të dështimit të tij për të kryer punet e kontraktuara konform kërkesave dhe Specifikave Teknike të shërbimit.

Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72 të Rregullave të Prokurim Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës

Faton Gutaj

Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Drejtorisë për Infrastrukturë
Drejtorisë për Buxhet dhe financa
Organit Mbikqyres "AL-Engineering";
Menaxherit të kontratës;
Arkivës së Komunës.